

Njoftimi i përqendrimit me të cilin Borealis AG nga Austria do të fitoj kontroll të pavarur mbi Rialti S.p.A. nga Italia

(lënda nr. 08-108 / 2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 18.07.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga Borealis AG me seli në Trabenshtrase 6-8, 1020 Vjenë, Austri mbi shoqërinë Rialti S.p.A me seli në Via Varese nr. 133 – 21020, Taino (VA), Itali, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

-Borealis AG është nën kontrollin e OMV, e cila direkt dhe indirekt (nëpërmjet shoqërive të saj të varura të OMV Daunstrim GmbH dhe OMV Borealis Holding GmbH) zotëron 75% të aksioneve në Borealis. Pjesa e mbetur prej 25% e aksioneve janë në pronësi të Kompanisë Abu Dabi Neshnl Oil, një shoqëri aksionare, aksionet e së cilës janë të listuara në bursë, e themeluar në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe është aksionar minoritar pa kontroll të menaxhmentit.

Grupi OMV është një grup i integruar ndërkombëtar, aktiv në mbarë botën në naftë, gaz dhe kimikate në tre segmentet e mëposhtme të biznesit:

-Energjetika – eksploatimi, zhvillimi, prodhimi dhe shitja e naftës dhe gazit, duke përfshirë rrjetin e vet të gazsjellësit dhe objektet e depozitimit të gazit në Austri;

-Karburantet & Lëndët e Para – të rafinuara përmes fabrikave të vendosura në Austri, Gjermani dhe Rumani që prodhojnë dhe shesin gaz natyror të lëngshëm, kerozin, naftë, gaz, naftë, lëndë djegëse të lehta të naftës, sqfur dhe koks të kalcinuar.

-Kimikatet & materialet – në këtë segment biznesi, brenda Grupit OMV, janë aktive vetëm Borealis dhe shoqëritë e tij të varura.

OMV nuk ka shoqëri të varura apo filiale në Maqedoninë e Veriut.

-Rialti S.p.A - një shoqëri aksionare nën kontrollin përfundimtar të një personi fizik, që është i specializuar në prodhimin e përbërjeve të qëndrueshme të polipropilenit (të ashtuquajturat "përbërjet PP") me fokus në lëndët fillestare të polipropilenit të ricikluar mekanikisht (PP) nga mbetjet industriale dhe të konsumatorëve. Me më shumë se tridhjetë vjet përvojë, Rialti përdor kapacitetin e saj prej 50,000 tonësh për prodhimin e përbërjeve PP me injeksion dhe nxjerrje PP me aplikim në industri të ndryshme, duke përfshirë industrinë e automobilave, mobileve, pajisjeve shtëpiake, ndërtimtarisë dhe kozmetikës. Rialti nuk ishte aktive në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022.

Tregu relevant i mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si treg **për përbërjet PP**.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

20.07. 2023

Shkup